




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	2-D/DPK
Nr. Prot. / Br Prot. / Prot No.	01-1904/14
Nr. ffaq / Broj stranica / No. pages	03
Data / Datum / Date	28.05.2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	27/05/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Burim ZEKAJ Udhëheqës i zyrës së Prokurimit – Trainkos sh.a
CC:	z. Betim GJOSHI Krye shef Ekzekutiv - Trainkos sh.a
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin “Furnizim me lokomotiva dizel elektrike”



I nderuar z. ZEKAJ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin : “Furnizim me lokomotiva dizel elektrike” me nr. prokurimi: TR/45005/14/005/511 Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Furnizim me lokomotiva dizel elektrike” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Trainkos, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Furnizim me lokomotiva dizel elektrike” me nr. prokurimi: TR/45005/14/005/511. Njoftimi është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së më datë 28/03/2014, me procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet si rast për trajtim dhe gjatë trajtimit të kësaj procedure, kemi hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin e Prokurimit në Kosovë.

Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet prokurimi ka paraparë punë dhe furnizim, në lot.1 (Punë) Riparimi Gjeneral i Lokomotivës, ndërsa lot2. (Furnizim) Furnizimi me lokomotivë dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar (mallra dhe udhëtar). E mundur është për një kontratë publike të jetë “kombinim” Furnizim/Shërbim, Punë/Shërbim; Punë/Furnizim; kombinim në Furnizim/Punë/Shërbime. Metoda bazike për të trajtuar këtë ndarje është gjithnjë modeli i kostos së thjeshtë. Cilido element i kontratës që ka shpenzimet më të larta të parashikuara kontrata duhet të klasifikohet nën atë lloj të kontratës. Kjo duhet të aplikohet edhe nëse kontrata është ndarë në “Lote”. Autoriteti Kontraktues është dashur që këtë kontratë ta klasifikoj si kontratë për furnizim, pasi vlera e lot.2 (furnizim) mbizotëron me koston ndaj lot.1.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka kufizuar Operatorëve Ekonomik që ofertën ta bëjnë në njërin nga gjuhët zyrtare dhe dokumentacioni përcjellës të përkthehet në mënyrë që vlerësimi i ofertave të jetë më i lehtë dhe më i saktë. Në ofertat e Operatorëve Ekonomik, ka pasur dokumente në gjuhë të ndryshme, të cilat e kanë vështirësuar punën e komisionit Vlerësues. Derisa, në Dosjen e Tenderit, tek lot.2, ka kërkuar që: Dokumentacioni teknik për mirëmbajtjen e lokomotivave dhe të dhënat teknike të lokomotivës i cili dorëzohet me lokomotivë i përkthyer në gjuhën shqipe; si dhe Dokumentacioni dhe udhëzimet për manipulim të lokomotivës i cili dorëzohet me lokomotivë i përkthyer në gjuhën shqipe.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues është dashur të kufizoj që edhe ofertat të dorëzohen në gjuhën shqipe, pasi gjithë zyrtarët që merren me këtë aktivitet prokurimi, janë njohës të mirë të kësaj gjuhe.

Autoriteti Kontraktues në vendimin e themelimit të komisionit vlerësues të ofertave, ka futur edhe njërin nga anëtarët që ka përgatitë specifikimet teknike të tenderit. Stafi i departamentit të kërkesës mundë të përcaktohet që të bëhet anëtarë i Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve, përveç personave të cilët kanë hartuar Specifikimet Teknike

Në Dosja e Tenderit, SEKSIONI II. FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT, pika 9.1 Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, lot 2, në nënpika 10 kërkohet që: Lokomotiva duhet ti plotësoj standardet e BE-së për emetimin e gazrave dhe nivelit të zhurmës. Autoriteti Kontraktues nuk ka cekur se në çfarë mënyre duhet të dëshmohet një gjë e tillë, nëse duhet certifikatë, deklaratë apo ndonjë dokumentacion tjetër shtesë që dokumenton kërkesën.

Në Dosja e Tenderit, SEKSIONI II. FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT, pika 9.1 Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, lot 1, në nënpika 7 kërkohet që: Operatori Ekonomik

(remontuesi) duhet të ofrojnë dëshmi se kanë kapacitetet teknike për kryerjen e riparimit gjeneral të lokomotivës. Dëshmia duhet të dorëzohet për pajisjet. Autoriteti Kontraktues nuk ka cekur se çka mund të merret si dëshmi për të dëshmuar kapacitetin teknik të Operatorit Ekonomik.

Në Njoftim për Kontratë, pika III.2.2 Përshtatshmëria profesionale, kërkohet Dëshmia e kërkuar dokumentare, pa pasur paraprakisht kërkesë për përshtatshmërinë profesionale. Nuk është kërkuar Certifikata e regjistrimit të biznesit dhe ajo e TVSH-së, ndërsa është kërkuar si dëshmi e kërkuar dokumentare.

Gjatë komunikimit mes Agjencisë Kundër Korrupsion dhe zyrtarëve të Trainkos, këta të fundit i kanë thënë agjencisë se lokomotiva (lot.1) që duhet të riparohet gjendet në Kroaci(Zagreb), atje ka mbetur para vitit 1999 dhe nga ajo kohë nuk është sjellë në Kosovë. Sipas të njëjtit zyrtar, thuhet se autoritetet Kroate të Hekurudhave i kanë komunikuar Trainkos-it se lokomotiva që është në territorin e tyre mund të tërhiqet në çdo kohë. Qëllimi i Autoritetit Kontraktues është që kjo lokomotivë duhet të funksionalizohet përmes riparimit gjeneral dhe vendosjes së pjesëve përkatëse në të. Përpos riparimit gjeneral të njëres nga lokomotivat (lot.1), Autoriteti Kontraktues kërkon që të pajiset me lokomotivë të vjetër (të vitit 1980). Sipas dispozitave të prokurimit Trainkos nuk lejohet që të furnizohet me mjete të vjetra, siç është rasti me lot.2.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 15 Klasifikimi i Kontratave të Përziera; nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; si dhe pika 9 Funksionet e Njesisë së Kërkesës; pika 14 Llojet e Kontratës; pika 23 Kriteret e përzgjedhjes nga Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje të këtij aktiviteti të prokurimit dhe shmangien e praktikave të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

